

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirëmbajtja dhe Suporti për Softin ODMS dhe ACC”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

72267100-0 - Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit.

VLERA E FONDIT LIMIT:

12,000,000 (dymbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e shërbimeve objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros të jetë në masën 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 4,000,000 (katër milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me këtë pikë:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Shenim: Kontratat e ngjashme në lidhje me shërbimin mirëmbajtjen si dhe zhvillimin e softit ODMS i cili përdoret për modelimin dhe analizen e sistemit të transmetimit të energjisë

elektrike, per vete specifiken dhe rendesine e vecante qe kane per OST, do te konsiderohen te tilla te gjitha shërbimet e ngjashme te realizuar ne funksion te sistemeve elektrike me nivel tensioni 110 kV e lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 33 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- *Autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për produktin Licensa ODMS.*
- *Autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për mirembajtjen dhe suportin e licensave ekzistuese për vitet 2023-2025 si dhe paramtrizimin e Licenses ODMS ACC.*
- *Autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për mirembajtjen dhe suportin e licensave të reja për vitet 2023-2025.*

Autorizimi/et e prodhuesit/distributorit të autorizuar duhet të përmbajne të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave/shërbimeve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave/shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuar) te leshtuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- **ISO 9001:** për menaxhimin e cilësisë
- **ISO 27001:** për menaxhimin të sigurisë së informacionit
- **ISO 45001:** për sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislati në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

- **Standarti i cilesise ISO 9001:** eshte sot referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Në lidhje me kërkesën që OE ofertues të paraqesë licencën e sipercituar është menduar si i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të siguruar AK që mallrat e ofruar do të jenë cilësorë dhe me parametra që plotësohen nga prodhues të licencuar sipas standarteve ndërkombëtare të cilësisë. Plotesimi i këtyre kriterëve nga ofertuesit e interesuar, garanton realizimin me sukses dhe me cilësi të objektit të kontratës.

- **Certifikata e menaxhimit te sigurise se informacionit ISO 27001:** eshte e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit. Per shkak te rendesise se veçante që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht ne sistemin elektro-energjitik, gjykohe se informacioni duhet mbrojtur dhe Kontraktori objekt procedure prokurimi, duhet te nderhyje ne sistemin e brendshem te AK. Certifikimi sipas kesaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve te OE ofertues dhe i jep sigurine e nevojshme AK.

AK duhet te marre çdo mase te nevojshme per parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarise se saj, ku per shkak te moscertifikimit te duhur te kontraktoreve, AK duhet te pezulloje ose te vonoje

veprimtarine e saj, duke shkaktuar nje dem te madh ne sistemin elektro energjistik shqiptar, ku eshte edhe objekti i saj kryesor.

- **Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:** është vendosur si kriter kualifikues per operatorët ekonomik ofertues sepse ka te beje me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila eshte me nje rendesi te vecante per kryerjen e ketij sherbimi. OE ofertues qe do te realizoje kontraten objekt procedure prokurimi AK duhet te marre çdo mase te nevojshme per parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarise se saj.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues për kryerjen e këtij shërbimi duhet të ketë numrin e nevojshem te punonjësve jo më të vogel se 7 (shtate) me kohë të plotë pune. Punonjësit duhet te jene te siguruar te pakten për 12 (dymbedhete) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listepagesat perkatese E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues për te bere te mundur kryerjen e këtij sherbimi duhet te provoje se ka ne stafin e tij kapacitetet teknike dhe profesionale si me poshte vijon:*

- *Nje **Menaxher Projekti** i cili duhet të jetë i diplomuar në nivel master për Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike/Telekomunikacion. Punonjesi duhet të ketë jo më pak se 10 vite eksperience pune në fushën IT.*
- *Per te garantuar sigurine, authenticitetin dhe disponueshmerine e komunikimit ne platformat ekzituese Microsoft, operatori ekonomik duhet te kete te pakten nje punonjës të kualifikuar për **Microsoft Security** ose ekuivalente. Punonjesi duhet të ketë jo me pak se 7 vite eksperience pune në IT, diplomë në Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike/Telekomunikacion.*
- *Per te garantuar meanxhimin sistemeve kompjuterike Microsoft operatori ekonomik duhet te kete te pakten nje punonjës të kualifikuar **Microsoft Certified Professional** ose ekuivalente. Punonjesi duhet të ketë jo me pak se 7 vite eksperience pune në IT, diplomë në Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike/Telekomunikacion.*
- *Per te garantuar sigurine e komunikimit ne rrjetet lokale te komunikimit, operatori ekonomik duhet te kete te pakten dy punonjës të kualifikuar për **Network Security** ose ekuivalente. Punonjesi duhet të ketë jo me pak se 7 vite eksperience pune në IT, diplomë në Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike/Telekomunikacion.*

- *Per te mundesuar mirembajtjen e bazes se te dhenave te sistemit, operatori ekonomik duhet te kete te punesuar nje punonjes te certifikuar ne **MS SQL Server Administration** ose ekuivalente. Punonjesi duhet të ketë jo me pak se 3 vite eksperience pune në IT, diplomë në Shkenca Kompjuterike/ Informatike/ Telekomunikacion.*
- *Per te garantuar meanxhimin e rrjetave kompjuterike te transmetimit te te dhenave, operatori ekonomik duhet te kete te pakten nje punonjës të kualifikuar në **CCNA** ose ekuivalente. Punonjesi duhet të ketë diplomë në Shkenca Elektronike/ Kompjuterike/ Informatike/Telekomunikacion.*

Per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, per te gjithë stafin e kerkuar me siper, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: CV-të, diplomat dhe certifikatat qe vertetojne se punonjesi i disponon aftesite profesionale te tij ne perputhje me kerkesat e lartpermendura.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Persa i perket kerkeses per nje **Menaxher Projekti**, ai gjykohet i nevojshem duke pare rendesine e ketij projekti dhe shtrirjen e tij, eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik te kete nje menaxher projekti te certifikuar e me pervojen e duhur per kete qellim.

Persa i perket kerkeses per nje punonjës të kualifikuar për **Microsoft Security**, gjykohet i nevojshem duke patur parasysh qe Platforma e sistemit operativ qe perdoret nga AK eshte Microsoft dhe rendesine e informacionit qe perpunohet ne keto sisteme, duhet qe stafi Teknik i OE ofertues te jete i certifikuar ne sigurine e ketij sistemi operativ.

Persa i perket kerkeses per nje punonjës të kualifikuar **Microsoft Certified Professional**, gjykohet si i nevojshem duke patur parasysh qe Platforma e sistemit operativ qe perdoret nga autoriteti kontraktor eshte Microsoft stafi Teknik i OE ofertues duhet te jete profesionalisht i afte ne perdorimin e sistemit Microsoft.

Persa i perket kerkeses per dy punonjës të kualifikuar për **Network Security**, eshte kerkuar pasi eshte gjykuar se siguria e transmetimit te te dhenave dhe komunikimeve elektronike ne kete procedure eshte pike kyce duke patur parasysh rendesine qe ka ky sistem.

Referuar kerkeses per nje punonjes te certifikuar ne **MS SQL Server Administration**, gjykohet si i domosdoshem pasi te gjitha te dhenat e sistemit mblidhen, perpunohen dhe ruhen ne bazen e te dhenave perkatese. Stafi Teknik i OE ofertues duhet te jete i certifikuar ne administrimin dhe menaxhin e bazave te te dhenave.

Persa i perket kerkeses per nje punonjës të kualifikuar në **CCNA (Cisco Certified Network Associate)**, gjykohet si i domosdoshem per transmetimit te te dhenave dhe komunikimeve elektronike ne kete procedure eshte pike kyce duke patur parasysh rendesine qe ka ky sistem prane AK.

Argumentimi: Ky kriter lidhet ngushte me specifikimet teknike për shërbimin e kërkuar, lidhur me menaxhimin në mënyrë të pavaruar. AK duhet të ketë besueshmëri dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet me se miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.7 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Ates, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, ates, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedurë prokurimi, duke përfshirë sasinë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.